URDHËR
Nr.36, datë 27.11.2006

PËR DISA SHTESA NË URDHRIN NR.2, DATË 3.12.2004 "PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT ARAB YASIN AL-QADI, I NJOHUR DHE SI: A) SAYKH YASSIN ABDULLAH KADI, B)YASIN KAHDI, C) YASSIN KAHDI, Ç) KADI YASSIN, D) YASSIN ADDULLAH KADI", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.2, datë 3.12.2004, i ndryshuar, bëhen shtesat si më poshtë vijojnë:

1. Në përmbajtjen e pikës 6, pas pikës 6.7 shtohen pikat 6.8, 6.9, 6.10, 6.11, 6.12, 6.13, 6.14, 6.15, 6.16 dhe 6.17, me këtë përmbajtje:

6.8 Pasuria (apartament) me sipërfaqe 114.4 m^2, në zonën kadastrale 8380, volumi 3, faqe 37, numër pasurie 283, datë 12.1.1994 me adresë: Tiranë, rruga "Vaso Pasha", pallati 2, shkalla 2, apartamenti 5 (i cili është i përbërë nga tri dhoma, një kuzhinë, banjë, korridor, në katin e I-rë mbi bodrumet), (indeks 111-283-12011994).

6.9 Pasuria (apartament) me sipërfaqe 75.5 m^2, në zonën kadastrale 8380, volumi 13, faqe 168, numër pasurie 7/135+7-86/2, datë 10.5.2000, me adresë: Tiranë, rruga "Rreshit Çollaku", pallatet e Shallvares, shkalla 7, apartamenti 86, (i cili është i përbërë nga tri dhoma dhe ambiente të tjera ndihmëse), (indeks 155-19747-04071994).

6.10 Pasuria (apartament) me sipërfaqe 71.3 m^2, me adresë: Tiranë, rruga "Bajram Curri", pallati 8, shkalla 1, apartamenti 3, (i cili është i përbërë nga dy dhoma, një kuzhinë dhe ambiente të tjera ndihmëse), (indeks 173-27518-14111994).

6.11 Pasuria (apartament) me sipërfaqe 88 m^2, volumi 3, faqe 37, numër pasurie 1/4+4-34, datë 26.5.2000, me adresë: Tiranë, Rruga e Durrësit, pallati 34, shkalla 4, apartamenti 79, (i cili është i përbërë nga tri dhoma, një kuzhinë, korridor, banjë, si dhe ambiente të tjera ndihmëse, në katin e parë), (indeks 111-284-12011994).

6.12 Pasuria (një shtëpi 2-katëshe, konstruksion tulle e mbuluar me tjegulla, si dhe një sipërfaqe trualli mbi të cilën ngrihet kjo shtëpi), me sipërfaqe 270 m^2, me numër prone "Parcela 79" e planit urbanistik, me adresë: Tiranë, fshati Selitë e Vogël (indeks 313-2544-04041996).

6.13 Pasuria (dyqan, ish-gjelltore, në Rrugën e Durrësit), me sipërfaqe 350 m^2, numër pasurie 4225, datë 21.6.2000, me adresë: Tiranë, Rruga e Durrësit, pallati 102, (indeks 307-6150-30.12.1995).

6.14 Pasuria (dyqan, ish-permanent, në Rrugën e Elbasanit) me sipërfaqen 47 m^2, si dhe një truall 47 m^2, mbi të cilin është ngritur dyqani permanent, numër pasurie 208, datë 21.1.1994, me adresë: Tiranë, Rruga e Elbasanit (permanenti ndërmjet repartit të berberëve dhe rrobaqepësisë), (indeks dyqani permanent 276-208-21011994, indeks trualli 47 m^2 307-6152-30121995).

6.15 Pasuria (lokal, ish-ëmbëltore në Rrugën e Durrësit) me sipërfaqe 175 m^2, si dhe një truall me sipërfaqe 175 m^2, mbi të cilin është ngritur lokali ish-ëmbëltore me nr.pasurie 944, datë 30.5.2000, me adresë: Rruga e Durrësit, Tiranë, (indeks lokal ëmbëltore 310-944-09021996, indeksi i truallit nën lokalin ëmbëltore 319-5558-25071996).

6.16 Pasuria (ndërtesë-magazina qendrore) me sipërfaqe 4437 m^2, si dhe një truall me sipërfaqe 4437 m^2, mbi të cilin është ngritur objekti ndërtesë "Magazina qendrore", numër pasurie 3537, datë 21.10.1993, me adresë: Laprakë, rruga "Pandi Dardha", Tiranë, numër (magazina qendrore ose ish-ofiçina e NB "17 Nëntori") (indeks objekti-ndërtesë-magazina qendrore, 3537-21101993, indeks trualli 307-6153-30121995).

6.17 Pasuria (truall) me sipërfaqe 22000 m^2, zona kadastrale 3866, numër pasurie 4376, datë 20.9.1997, me adresë: Tiranë, fshati Yzberisht, kufizohet me rrugën automobilistike (indeks 339-4376-20091997).

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, si dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode